



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E LISTAVE EMËRORE TË SHTETASVE TË CILËT MUND TË EMËROHEN KRYESISHT ANËTARË TË KQV-VE PËR ZGJEDHJET PËR NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30.06.2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 21.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me

OBJEKT: Për miratim të listave emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", nenin 37, nenin 38, i ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe propozimet e depozituara,

V Ë R E N

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të përcaktimeve të Udhëzimit nr. 4, datë 19.02.2013 "Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ, për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV", i ndryshuar, ka publikuar në gazeta dhe faqen e internetit njoftimin për shprehje interesi nga shtetas që janë të gatshëm të ushtrojnë detyrën e anëtarit të KQV-së për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

KQZ, përmes njoftimit publik informoi shtetasit për kushtet për t'u emëruar anëtar i KQV-ve, në respektim të përcaktimeve të nenit 38 të Kodit Zgjedhor, dokumentacionin që duhej paraqitur dhe afatin e aplikimit.

Në përgjigje të njoftimit publik të KQZ-së, në 7 Zona Zgjedhore/Bashki, kanë shprehur interes 636 shtetas.



Nr. 849 i Vendimit

Data 21.06.2019 e Vendimit Ora 10:00 e Vendimit

Për miratimin e listës emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019

DPB me shkresën nr. 11569 prot., datë 18.06.2019, ka kthyer përgjigje për rezultatet e verifikimit të gjendjes gjyqësore të shtetasve me vendbanim në bashkitë si më poshtë:

1. Bashkia Finiq	138 shtetas
2. Bashkia Maliq	135 shtetas
3. Bashkia Selenicë	89 shtetas
4. Bashkia Kukës	79 shtetas
5. Bashkia Elbasan	195 shtetas
6. Bashkia Kuçovë	8 shtetas
7. Bashki Fier (Levan)	27 shtetas

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur dhe verifikimit të të dhënave, rezulton se shtetasit që kanë shprehur interes për tu emëruar kryesisht anëtarë të KQV në tetë zonat zgjedhore si më sipër listuar, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 dhe 38 të Kodit Zgjedhor, me përjashtim të nëntë shtetasve, të cilët nuk plotësojnë kriterin e nenit 38, gërma "ç" të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 23, pika 1, nenin 37, nenin 38, i ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Të miratojë listën emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve të ZAZ-së nr.89, Bashkia Finiq, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes 1 bashkëlidhur.
2. Të miratojë listën emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve të ZAZ-së nr.68, Bashkia Maliq, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes 2 bashkëlidhur.
3. Të miratojë listën emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve të ZAZ-së nr.85, Bashkia Selenicë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes 3 bashkëlidhur.
4. Të miratojë listën emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve të ZAZ-së nr.11, Bashkia Kukës, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes 4 bashkëlidhur.
5. Të miratojë listën emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve të ZAZ-së nr.47, nr.48, nr.49, nr.50, Bashkia Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes 5 bashkëlidhur.



Nr. 849 i Vendimit

Data 21.06.2019 e Vendimit Ora 10:00 e Vendimit

Për miratimin e listës emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019

6. Të miratojë listën emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve të ZAZ-së nr.63, Bashkia Kuçovë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes 6 bashkëlidhur.
7. Të miratojë listën emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve të ZAZ-së nr.57, Bashkia Fier (Njësia Administrative Levan), për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes 7 bashkëlidhur.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
9. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 849 i Vendimit

Data 21.06.2019 e Vendimit Ora 10:00 e Vendimit

Për miratimin e listës emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019